

SHKOLLA SHQIPE NË POZHORAN DHE KONTRIBUTI I MËSUESIT
SYLEJMAN SALHIU – MULLA SYLA

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I HISTORISË

NGA

ARJETA SHEMA - ARIFI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“ HASAN PRISHTINA “

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

JANAR, 2022

REZYME E TEMËS:

SHKOLLA SHQIPE NË POZHORAN DHE KONTRIBUTI I MËSUESIT SYLEJMAN SALHIU – MULLA SYLA

ARJETA SHEMA – ARIFI

Mentor: Prof. Dr. Bujar Dugolli

Krahas shkollës së Stubllës, në territorin e Moravës së Epërme, në vitin 1909, në fshatin Pozhoran u hap shkolla e parë në gjuhën dhe alfabetin shqip, për të cilën meritat më të mëdha për këtë veprë të madhe kombëtare, pati angazhimi i Hasan Prishtinës, i Islam Pirës më shokë dhe i arsimdashësit, rilindësit e iluministit të vërtetë të Anamora-vës, mësuesit Sylejman Salihu i njohur si Mulla Syla nga Tërpeza.

Mulla Syla, ishte hoxhë, por edhe mësues i diplomuar në shkollën normale në Shkup në gjuhën osmane. Mirëpo, ai, në saje të interesimit dhe punës së përkushtuar për dije dhe arsim të vetes dhe të popullit të tij, arriti të mësonte mirë dituritë fetare e shkencore dhe ato kombëtare, të bëhej kultivues dhe krijues i vërtetë i shumë punimeve në gjuhën osmane, arabe dhe shqipe. Këtë aftësi ai e transmetoi përmes punës si hoxhë, e sidomos në shkollë, gjatë mësimit të nxënësve, të rinisë, por edhe të pjesëtarëve të moshuar të popullit shqiptar. Në këtë kohë mësimi zyrtarisht zhvillohej në gjuhën osmane me alfabet arab, por Mulla Syla, duke qenë një pedagog dhe patriot i vërtetë, për t'ua bërë më të qartë përmbajtjen mësimore të nxënësve dhe popullit, në xhami, e sidomos në shkollë, interpretimin, komentimin e përmbajtjeve kuranore dhe atyre mësimore, shpjegimin, pyetjet dhe përgjigjet më nxënës, rregullisht i bënte në gjuhën shqipe.

Pas ndërtimit, hapjes zyrtare dhe fillimit me sukses të punës së shkollës së parë shqipe në Pozhoran, në tetor të vitit 1909, siç u hapën kudo në viset shqiptare, e sidomos në Kosovë, Mulla Syla ishte mësuesi i parë i kësaj shkolle.

Për sa i përket objektit të shkollës së parë shqipe në Pozhoran, tani ndërtesa e kësaj shkolle është (rrethuar, 2009) rindërtuar me një ndërtesë të re, e cila ka disa ngjashmëri, por dallon shumë nga ajo vjetra.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të paraqes një edhe disa detaje më shumë lidhur me shkollën shqipe në Pozhoran, personalitetin dhe mësuesin e parë Sylejman Salihun (Mulla Sylën) dhe dhe ngjarjet e mëpastajme që e shoqëruan shkollën dhe këtë lokalitet.

Përveç literatures në këtë punim dua të prezantoj ngjarjet edhe në bazë të dokumenteve arkivore dhe dokumenteve të ndryshme nga personalitet më të shquar të arsimit mbarëkombëtar të asaj kohe.

Kurse metodologjia sa më efikase është ndër procedurat më të rëndësishme të punës në trajtimin e kësaj teme. Prandaj, ajo duhet të jetë e përshtatshme për qëllimin dhe synimin e jo anasjelltas. P.sh në disa raste të hulumtimit janë sistematikisht të praktikuara analizat e diskursit, të cilat më kanë hyrë në punë për të zgjeruar horizontin e ngjarjes dhe aspektit të studimit të tyre. Në hulumtimin tim dhe përpunimin e kësaj teme jam mbështetur në metodologjinë e hulumtimit sistematik në arkiv, duke grumbulluar të dhëna nga literature dhe dokumentet arkivore.

Kështu në metodologjinë e punës që kam përdorur, kryesisht jam përpjekur që të bëj dallimin mes ngjarjes në tërësi se si është përshkruar deri tash dhe një këndvështrim timin si hulumtuese e re.

Punimi im, bazë dhe qëllim ka pordorimin e metodës kualitative në kuptimin e një cilësie të lartë dhe ku njëkohësisht do të përfshihen burime arkivore dhe argumentet e literaturat më kredibile, si dhe të dhëna nga autorë shumë të shquar dhe eminent. Kurse referencat, pikërisht do të përfaqësojn botime të ndryshme, që paanshëm trajtojnë këtë problem, pastaj Institucione dhe artikuj shkencor të ndryshëm dhe relevante.

Në Kapitullin e parë, jam orjentuar më shumë në atë që ka të bëjë me shkollën e Pozhoranit, fillimi i punimeve dhe kontribuesit e saj, historikun e shkollës shqipe në Pozhoran, ndërtimin e shkollës dhe kontributi i Islam Pirës me shokë, të dhënat historike për ndërtimin e shkollës, Islam Pirën dhe mbishkrimi i shkollës së parë shqipe në Pozhoran, Mësuesin e parë Sylejman Salihun (Mulla Sylën) dhe ditën e parë në shkollën shqipe në Pozhoran, si ngjarje e madhe për arsimin kombëtar në Anamoravë dhe më gjerë.

Kapitulli i dytë, ka të bëjë me veprimtarinë e mësuesit Syljeman Salihut dhe pjesamarrjen e tij në shumë Kuvende, si në Kuvendin e Ferizajit, tubimi i shqiptarëve në Pozhoran pas fitores së Revolucionit XhonTurk, pastaj fillimin e veprimtarisë arsimore, fetare e kombëtare të Mulla Sylës, puna e tij si hoxhë, mësues, administrator civil në Gjimnazin në Shkup, dhe krejt në fund janë përmendur edhe disa detaje për abetaren shqipe, që Mulla Sylë morri nga Hasan Prishtina.

Në kapitullin e tretë, jam fokusuar tek shkollimi i Sylejman Salihut, veprimtaria dhe krijmtaria e tij, ku kam trajtuar shkollimin e tij në Gjilan dhe kushtet e shkollimit, klubet dhe shoqëritë kombëtare ku morri pjesë, angazhimet arsimore, kulturore e politike, të dhënat për krijmtarin e tij, pikëpamjet e tij mbi kombin dhe atdheun. Gjithashtu në këtë kapitull kemi trajtuar edhe shkollat shqipe në Viti, si shkollën e Stubllës dhe Pozhoranit, si shkollat e para shqipe në rrethinën e moravës së epërme, Mulla Sylën si mësues dhe pedagog i vërtetë i arsimit shqip në Anamoravë, dhe veprimtarinë e Hasan Prishtinës për shkollat shqipe në Anamoravë e veçënisht në fshatin Pozhoran.

Kurse në kapitullin e katërtë dhe të fundit, kam trajtuar rrethë këndëvështrimeve, teksteve, shkrimeve, veprave dhe shkresat e Sylejman Salihut, pjesamarrja e tij në pajtimin e ngatërresave, veprimtarinë letrare, arsimore, shkencore, dorëshkrimet, shkrimet, mendimet dhe porositë, shkresat drejtuar Drejtorisë së lartë të shkollës, kërkesat e shtruara për libra dhe tekste shkollore në gjuhën shqipe, gjithashtu në këtë kapitull janë përfshirë edhe gjendja e shqiptarëve gjatë luftës së parë botërore, Kosova-Anamorava nën sundimin Bullgar, dhuna, vrasjet, plaqkitjet, internimet etj, punësimi i Mulla Sylës si mësues i lëndës fetare, iniciativa e Mulla Sylës për ndërtimin e xhamisë në Terpezë, gjendja e arsimit nën pushtimin Jugosllav, dhe krejt në fund edhe vdekja dhe varrimi madhështor i Mulla Sylës.